



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 8 TETOR 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 08. OKTOBRA 2016. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR
2016**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për “Trepçën”

Dnevni red

1. Drugo razmatranje Nacrta zakona o “Trepči”

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë

Jemi në punimet e seancës së re plenare, në fakt duhet ta konstatojmë se jemi më datën 8 tetor, aktualisht kur po e fillojmë seancën e re plenare.

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të caktuar në seancën e mëparshme.

Fillojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për “Trepçën”

Komisioni Funkcional, në bazë të vendimit të seancës së mëparshme, e ka shqyrtuar Projektligjin për “Trepçën” dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Muhamet Mustafa, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e Komisionit.

MUHAMET MUSTAFA: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë dhe Tregti, duke u bazuar në debatin që e kemi pasur sot, një debat përmbajtjesor dhe konstruktiv, duke u bazuar edhe në propozimet që i kemi marrë edhe nga shoqëria civile dhe duke u bazuar edhe në raportin e Komisionit dhe në debatin në Komision që kemi pasur, ka bërë amendamentet në projektligjin të cilën e miratuar në parim në seancën paraprake.

Unë besoj që e kemi marrë raportin, apo duhet ta lexoj krejt? Atëherë mirë pra, unë po e lexoj, më duhet ta lexoj. Ju lutem!

Në përgjithësi, amendamentet shkojnë në disa drejtime dhe e absollojnë një pjesë të madhe të diskutimeve.

Së pari kemi të bëjmë me forcimin e rolit të Kuvendit. Në këtë drejtim, në tri amendamente, roli i Kuvendit është forcuar. Kuvendi e jep pëlqimin, e aprovon statutin para se aksionarët ta aprovojnë definitivisht. Domethënë, aksionarët nuk mund ta aprovojnë statutin e tyre nëse paraprakisht Kuvendi i Kosovës nuk e ka aprovuar. Ky është ndryshimi esencial.

Në pikën tjetër, Kuvendi duhet ta japë pëlqimin lidhur me shfrytëzimin e pasurive natyrore dhe transformimet pronësore. Të gjitha transaksionet tjera biznesore që kanë të bëjnë me mikromenaxhment mbeten përgjegjësi e bordit mbikëqyrës me pëlqimin e Qeverisë.

Shkojmë me radhë:

Gjithashtu ne kemi pasur diskutime lidhur me shpërndarjen e aksioneve për kategori të caktuara të punëtorëve, për kohën, për të gjitha këto.

Ne e kemi aprovuar një amendament në Komisionin Funkcional, sipas të cilit në “Trepça” sh.a., mënyra e ndarjes së aksioneve, më konkretisht në mënyrë operationale do të përcaktohet me një akt nënligjore.

Një amendament tjetër i rëndësishëm është që i kemi trajtuar edhe mbetjet teknologjike, të cilat Bordi Mbikëqyrës i “Trepçës” është i detyruar t’i trajtojë në bazë të standardeve mjedisore dhe në bazë të studimit të fizibilitetit.

Një çështje tjetër e rëndësishme me amendamente ka të bëjë me asetet e “Trepçës” jashtë Kosovës.

Ne e kemi obliguar AKP-në që t’i mbrojë të drejtat e “Trepçës” dhe të drejtat e Kosovës lidhur me pasurinë apo me asetet e “Trepçës” jashtë Kosovës, t’i ndërmarrë të gjitha aktivitetet dhe masat e nevojshme.

Amendament tjetër i rëndësishëm është edhe ai lidhur me kërkesat e kreditorëve. Ne kemi një amendament të ri, domethënë një amendament që bën një tekst të ri të projektligjit dhe atë në konsultim me Agjencinë Kosovare të Privatizimit që është shumë më preciz dhe shumë më i mirë se sa teksti i ligjit dhe në këtë mënyrë “Trepça” është më e mbrojtur, më mirë e mbrojtur me tekstin e amendamentit që kemi aprovuar për këtë çështje.

Këto janë esenciale, komisioni nuk ka aprovuar amendamente, të cilat e ndryshojnë konceptin e ligjit, për të cilat u zhvillua debat, por për të cilat nuk pati konsensus dhe pati mendime të ndryshme. E dyta, ne shprehim keqardhje që në mbledhjen e fundit të komisionit, kolegu ynë, anëtar i komisionit, Sasha Milosavljeviq, nuk ishte prezent edhe përkundër faktit që unë pata një bisedë me të dhe ai ma shprehu gatishmëri se do të vijë në komision dhe t’i prezantojë amendamentet.

Ne ishim të gatshëm që me durim t’i diskutojmë edhe ato amendamente, por nuk erdhën amendamentet.

Çështja tjetër që ka të bëjë me diskutimin, mendoj se edhe me diskutim në komision, ku kanë marrë pjesë edhe të tjerë që nuk janë anëtarë të komisionit, edhe nga partitë opozitare, por edhe nga “Trepça” dhe nga AKP-ja, i kemi dhënë mundësi gjithkujt të marrë fjalën, sa herë ka dashur. Ka qenë një atmosferë tolerante, votimi është bërë pas argumenteve dhe mendoj se është votimi i drejtë. Me këto amendamente, ato drejtime dhe orientime që i ka dhënë Kuvendi dhe që kanë shkuar në drejtim të përmirësimit të ligjit dhe forcimit të rolit të Kuvendit dhe mbikëqyrjes shoqërore janë aty, por i gjithë koncepti i ligjit ka mbetur dhe ai koncept garanton një “Trepçë” prosperuese, garanton interesat publike, garanton interesat e komunitetit, garanton interesat e punëtorëve dhe është atraktiv për investitorët dhe këtë po e theksoj, se që të mbetemi atraktiv për investitorët është esenciale për perspektivën e “Trepçës”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, profesor! Faleminderit për kontributin gjatë krejt këtij procesi.

Të nderuar kolegë deputetë, tanimë nuk ka të lajmëruar për diskutim, s’kanë kërkuar komisionet funksionale. Për këtë projektligj janë propozuar gjithsej 21 amendamente. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit FunkSIONAL.

Shikojmë sa deputetë i kemi aktualisht, edhe në mënyrë fizike, edhe elektronike, me kartela të regjistruara janë 104, do të votojmë secilin amendament veç e veç, të mos kemi konfuzion, ka mundësi për të njëjtin amendament të kemi dy propozime, do ta votojmë dy herë, edhe për ta qartësuar pozicionin tonë.

Deputeti Nait Hasani thotë se asnjë material nuk e ka para vetes. 93 deputetë jemi aktualisht në sallë, do të thotë kemi kushte të mira për vazhdimin e seancës, ja erdhën edhe materialet ndërkohë.

Derisa shpërndahen, unë nuk do të futem në procedimin e votimit të amendamenteve. Atëherë, janë krijuar kushtet për votim.

Amendamenti 1, janë dy propozime do të shikojmë, unë nuk do t’i lexoj vetëm në qoftë se ju dëshironi, reagoni kur dëshironi, unë pastaj i lexoj.

Amendamenti “A”, propozimi i Komisionit FunkSIONAL. Lus deputetët, në mënyrë elektronike do të votojmë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash. Komisioni FunkSIONAL “A”.

69 deputetë kanë votuar. Në fakt, kërkoj falje, po duket se s’po funksionon, atëherë shikojmë me dorë. Në bazë të traditës tonë të vjetër. A shikojmë me dorë? Më fal, se s’po dëgjoj. Po e përsëritim, por a shikojmë me dorë? Atëherë, në mënyrë elektronike, edhe njëherë e përsëritim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e amendamentit të parë nga Komisioni Funkcional, propozimi për “A”-në. Votojmë tash!

81 deputetë kanë votuar, 78 për, ose unë jam shumë gabim, ose diçka, a po e shihni atje.

94 deputetë janë në sallë, ndërkohë në mënyrë elektronike kanë votuar 81 deputetë. 78 për, 3 kundër. Edhe një herë për hir... apo del atje lart?

Të nderuar kolegë deputetë, mënyra elektronike po shihet që do të krijojë bukur disa kokëçarje, për hir të konfidencës edhe publike, edhe rritjes së transparencës, a shkojmë në mënyrë tradicionale me dorë. Shkojmë me dorë, edhe po shkojmë më shpejt. Përgatitemi për votim.

Jemi tek amendamenti 1, Komisioni Funkcional, nën “A”,
Unë do të shkoj, kush është kundër? A ka kundër?
A ka abstenim?

Kush është për? 93 deputetë janë në sallë, atëherë të gjitha votat unanime.

Shkojmë, e kemi edhe një propozim tjetër, po për të njëjtin amendament. Ka Rregullore, këtë pjesë nuk guxoj ta shkel. Amendamenti i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” tani vihet për votim. Urdhëro, ndërkohë Glauk Konjufca e kërkon fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Këtu nevojitet një shpjegim u shkurtër, sepse të dy këto amendamente që kanë të bëjnë me nenin e parë, unë mendoj se nuk janë në kundërtënie me njëra-tjetrën dhe kjo është arsye pse votuam edhe versionin e komisionit ne, sepse amendamenti i parë ka të bëjë me shpalljen e “Trepçës” si kompani me rëndësi të veçantë, si ndërmarrje me rëndësi të veçantë kjo është pozitive.

“Trepça” duhet ta ketë një kategorizim si ndërmarrje e rëndësisë të veçantë, kurse amendamenti ynë ka të bëjë me shpalljen e saj si ndërmarrje publike, të karakterit publik. Kur është e rëndësisë së veçantë, unë mendoj që është kundërtënëse të mos shpallet si publike, pastaj. Pra, unë mendoj që këto dyja janë plotësuese me njëra-tjetrën.

Prandaj amendamenti i Lëvizjes “Vetëvendosje” që ka të bëjë me nenin një, që është aty ku thuhet “ky ligj ka për qëllim krijimin e infrastrukturës ligjore”, ne jemi vetëm për t’ia shtuar fjalinë “për të transformuar njësitë e caktuara biznese të ndërmarrjes ekzistuese “Trepça” në ndërmarrje publike qendrore”. Këtë fjali duam t’ia shtojmë dhe kjo vetëm sa e plotëson atë që përnjëmend ta shpallim atë që u votua më herët, pra “Trepçën” si ndërmarrje të rëndësisë së veçantë.

KRYETARI: Atëherë, jemi te votimi: Është amendamenti i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Kush është kundër?

94 deputetë janë në sallë.

Kush është për?

A ka abstenim? 2 janë, edhe zoti Nait është. Vetëm ta marrim gjendjen për ta konstatuar zyrtarisht.

94 deputetë kanë qenë, 2 janë abstenim, Lëvizja “Vetëvendosje” për. 94 vota ishin, 14 deputetë kanë votuar për, 2 kanë abstenuar. Do të thotë, 78 kanë qenë kundër. Nuk kalon.

Amendamenti 2. Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, pa përkrahjen nga Komisioni FunkSIONAL. Ju kisha lutur që të përgatitemi për votim.

Amendamenti 2.

Kush është për?

A ka abstenim?

Kush është kundër? Në qoftë se i kemi 94, minus 14 mbesin 80 kundër dhe 14 për.

Nuk kalon.

Amendamenti 3. Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, pa përkrahjen nga Komisioni FunkSIONAL. Urdhëro, çdoherë. E ka fjalën Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Sepse, unë seriozisht dhe njëherë po dua ta shfrytëzoj rastin që t’i lus deputetët e koalicionit qeverisës që ta shqyrtojnë mundësinë e përmirësimit thelbësor të këtij ligji, për arsye se unë mendoj që nuk është përmirësuar asgjë dhe “Trepça” nuk mund mbrohet me të vërtetë nëse nuk e kategorizojmë si ndërmarrje publike.

Kjo nuk e prejudikon kurrfarë mase, apo kurrfarë strategjie të ardhshme të Qeverisë së Kosovës sa i përket kësaj ndërmarrjeje. Këto mund të reflektohen edhe dallime ideologjike. Për shembull, Qeveria ka vendosur një strategji të caktuar për Postën, për shembull, për arsye se ju ka dukur ajo më adekuatja dhe edhe pse është ndërmarrje publike, kjo nuk i ka përjashtuar masat që Qeveria i sheh të arsyeshme në raport me politikat e saj se si të veprojë me një kompani, me një ndërmarrje të caktuar publike.

Pra, kjo që “Trepça” të shndërrohet në shoqëri aksionare, por t’i mohohet në të njëjtën kohë karakteri i saj publik, unë mendoj që nuk ka kurrfarë kundërthënie këtu, mund të jetë shoqëri aksionare e karakterit publik. Unë mendoj se kështu mbrohet më mirë “Trepça” dhe ndërhyrja jonë është që aty te neni 3 që është pika 1.1 të thuhet: “Trepça”, ndërmarrje në administrim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit që ka qenë deri më tash” të shtohet fjalia “e transformuar me

njësitë biznesore të parapara me këtë projektligj si ndërmarrje publike qendrore në pronësi të Republikës së Kosovës”.

Unë nuk e di pse, çka kanë problem deputetët për shembull ta votojnë një ndryshim të tillë që është shumë i rëndësishëm.

KRYETARI: Faleminderit! Lus kolegët deputetë të përgatiten për amendamentin 3, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Jemi 93 deputetë.

Kush është për? Faleminderit!

A ka abstenim?

Kush është kundër?

Faktikisht po i shoh disa deputetë edhe s’po votojnë, po kjo merret kundër. Edhe njëherë kush është kundër, se duhet të numërohen tamam kush është kundër. Ju kisha lutur, kërkuj falje, por duhet për hir të korrektësisë.

Pothuajse të gjithë janë kundër, edhe Naiti ishte kundër, befasi ka qenë këtë herë, se Naitin e kemi t’u ndihmojë të gjithë juve të mos u lënë pak.

14 vota ishin për. Abstenim nuk kishte. Nga 93 deputetë, 75 kanë qenë kundër.

Nuk kalon.

Amendamenti 4, Komisioni FunkSIONAL. Përgatitemi për votim.

Kush është kundër? Nuk ka!

Abstenim a ka? Një e kemi deri tani.

A mund të konsideroj se janë të gjithë për, pjesa tjetër? Më fal, se po e shoh ka dilema.

Atëherë, 73 deputetë janë për. 3 s’kanë votuar fare dhe 1 kundër.

Kalon.

A do ta provojmë edhe njëherë në mënyrë elektronike, po e provojmë, në qoftë se ju pajtoheni.

Amendamenti 5. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten, të votojnë në mënyrë elektronike. Votojmë tash... me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

82 deputetë kanë votuar. 81 për, 1 abstenim.

Kalon amendamenti 5.

Amendamenti 6, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash.

82 deputetë kanë votuar. 81 për, 1 abstenim.

Amendamenti 7, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, Shqipe Pantina e ke kërkuar fjalën, e dëshiron fjalën? Urdhëro, fjala është për deputeten Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Shumicën e rasteve nuk po funksionon aparatura, kjo do të thotë se diku do të regjistrohet ky votim, do të regjistrohet edhe për secilin deputet individualisht.

Ka raste kur ne s’po mund të votojmë as pro, as kundër, as të abstenojmë. Kështu ose zgjidhni aparaturën, ose po vazhdojmë votimin në formë klasike.

KRYETARI: Është e vërtetë, ka probleme, nuk kanë faj deputetët. Ka probleme me aparaturë se po e vërejmë që herë e regjistron, herë jo.

Jemi te amendamenti 7, a vazhdojmë në mënyrë fizike, me dorë.

92 deputetë janë, po më vjen keq, por është e vërtetë, nuk është duke funksionuar siç duhet teknika. Kur vjen kryetari i ri e fut të re teknikën edhe rregulloren.

Amendamenti 7, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” pa përkrahjen nga Komisioni Funkcional, e ka fjalën kryetari i grupit, Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Shikoni, para se të dal te kjo, sërish dua t’u kthehem këtyre problemeve teknike.

Më herët the se në sallë, e konfirmove praninë, sa deputetë janë të pranishëm, the 94? Ne të gjithë votuam, kësaj radhe edhe Lëvizja “Vetëvendosje” votoi krejt, edhe koalicionet votuan krejt, dhe dolën 81 vota në fund.

A po më kuptoni? Domethënë, 13-14 vota nuk i paraqet fare aparatura, nuk është duke i regjistruar. Këto janë vota të humbura dhe kjo është shkelje, së pari shkelje ligjore, shkelje e Rregullores, se kur deputeti është i pranishëm dhe e ka vullnetin për të votuar edhe një gabim teknik ia pamundëson ta shprehë vullnetin e tij, kjo është parregullsi dhe nuk mund të shkojë kështu. Ose, rregullojini këto instrumentet e votimit...!

KRYETARI: Unë, në qoftë se tregoj korrektësi, se po më duket që s’po punon, por derisa ne po flasim, regjia çdoherë thotë “po punon”. Po, unë po i bie vërtetësisë suaj, sido që të jetë, prania është kjo që është.

Ganimete Musliu e ka kërkuar fjalën, por në ndërkohë vetëm t’jua sqaroj. Prania po, por nganjëherë edhe nuk po votojnë.

GLAUK KONJUFCA: Më dëgjoni! Dy gabime teknike janë duke ndodhur në të njëjtën kohë. Te ne, që po na i qet votat atje në ekran, atje lart, këtu zakonisht aparatura, sepse ne jemi mësuar, e dimë si funksionon kjo, na e qet edhe neve këtu pasqyrën se sa kanë votuar, sa kanë abstenuar, sa kanë votuar për dhe sa kanë votuar kundër. Atë nuk po e qet, ky është gabimi i parë. Gabimi i dytë është që nuk po i regjistron 13 apo 14 vota të të gjithë atyre që po votojnë. Këto janë dy gabime shumë...

KRYETARI: Ndërsa ju po flisni, Administrata po bën përpjekje për të na bindur. Ganimete Musliu e ka fjalën, ndërkohë e shfrytëzojmë si të vendosni ju. Shqipe Pantina ka votuar për. Nuredin Ibishi ka votuar për.

Unë nuk po e nënvlerësoj atë që po e thoni ju, sido që të jetë ju vendosni, unë do ta vë në votim në seancë, më mirë. Ganimete Musliu e ka fjalën, pastaj do të marr konsultimin tuaj me seancë.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Unë mendoj që deri te amendamenti 5 kemi shkuar shumë mirë, do të thotë në formën klasike, krejt çfarë duhet, duhet të kthehemi dy amendamente mbrapa, sepse vetëm amendamentet 6 dhe 7 krijuan paqartësi.

Besoj që s'kemi nevojë më shumë të humbim kohë, se edhe ashtu jemi shumë vonë. Të kthehemi me dy amendamente dhe të vazhdojmë të votojmë në mënyrë klasike, sepse nuk është edhe ku me ditë çfarë problemi që t'i numërojmë. Sepse neve sinqerisht nuk po na jep sinjal se si po regjistrohet vota jonë, për ose kundër. Faleminderit!

KRYETARI: Ju vendosni, pavarësisht insistimit të regjisë se regjistrimi i votës suaj po ndodh.

Unë kërkoj prej juve deklaram. Më falni, kam insistim nga Administrata...

Jo, jo, nuk do të futem t'i lexoj edhe një herë. Në qoftë se seanca vendos, a dëshironi ta konsideroni si të rregullt seancën për votimet, veçanërisht të amendamentet 6 dhe 7, se të tjerat s'kanë pasur probleme? Po! Atëherë, po jua lexoj!

Kush e ngre dorën, secili që e ngre dorën, unë pastaj i tregoj në bazë të listës se a ka votuar. Jo, jo, kush e ngre dorën, kush ka nevojë ta verifikojë votën. Vetëm pak, për Teutën... kërkoj falje...!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Edhe një herë, ju duhet të vendosni për arsye se, në qoftë se e shikojmë praninë e kartelave, aktualisht i kemi 102 kartela në mënyrë elektronike, derisa në votim, nëse flasim për amendamentin 6 kanë marrë pjesë vetëm në fakt 81 deputet për dhe 1 abstenim, do të thotë 2.

Atëherë, kthehemi më mirë. Nga amendamenti 5 kthehemi edhe një herë. E dëshironi edhe 5-shin ta futim edhe një herë, gjashtëshin? Ok, te gjashtëshi jemi.

Amendamenti 6 me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Lus Administratën të bëjë regjistrimin. Më falni! Unë do të shkoj vetëm për - kundër. Në qoftë se s'ka për ose kundër, krejt të tjerët që janë të pranishëm konsiderohen për ose kundër, e shikoj se cilët janë më shumë. Jo, të lutem, se s'mundem.

Ma jep praninë! 93 deputetë. Amendamenti 6 me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, a ka kundër? A ka abstenim? Të gjithë janë për, 93. Kaloi.

Amendamenti 7

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Urdhëro Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Shqetësimi im është ky: Ju s'po mund ta rregulloni një aparaturë me pesë susta, qysh doni ta ndreqni “Trepçën”?! Ky është halli im. Pesë susta i ka kjo aparaturë që e kemi përpara ne edhe shih sa e vogël, po doni gjigantën ekonomik “Trepça” ta ndreqni!

KRYETARI: Glauk, po të mos kisha qenë në publik do të ta jepja përgjigjen, por pasi jam këtu në publik s'po ta jap.

GLAUK KONJUFCA: Mund të dalësh edhe në jopublik, për të ma dhënë përgjigjen, nuk është problem. Je mësuar ashtu!

Sa i përket nenit 7, Lëvizja “Vetëvendosje” e ka këtë propozim, që nenit 5, paragrafit të parë t'i shtohet një pasus plotësues me këtë përmbajtje: “Minierat, respektivisht resurset minerale, nuk mund të jenë në asnjë mënyrë objekt i aksionit të tjetërsuar”.

Dhe, arsytimi ynë është ky: vetë përmbajtja e paragrafit 1 të nenit 5 të projektligjit tregon për rëndësinë e resurseve minerale, duke i përcaktuar ato taksativisht si pronë e Republikës së Kosovës. Kështu që me amendamentin e propozuar, pas përcaktimit laksativ të pronësisë së resurseve, është i nevojshëm ndalimi i qarkullimit juridik mbi pronësinë e sovranizuar të Republikës së Kosovës.

Miratimi i këtij amendamenti siguron pajtërsueshmërinë e minierave dhe resurseve si komponentë strategjike të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Jemi te amendamenti 7. Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, pa përkrahje nga Komisioni FunkSIONAL. Ju lutem praninë, sa deputetë jemi? 92

deputetë. Kush është për? A ka abstenim? Krejt pjesa tjetër konsiderohet kundër. Ma jepni gjendjen!

92 deputetë, 14 deputetë kanë qenë për, 78 kundër. Nuk kalon!

Amendamenti 8 me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Kush është kundër? A ka abstenim? Të gjithë jemi për. Kalon!

Amendamenti 9. Urdhëro Raif Qela, për cilin amendament, qartësohu!

RAIF QELA: Gabim teknik në të shtypur. Duhet “mbetjeve” e jo “mbejteve”, është veç gabim teknik.

KRYETARI: Të lutem, cilit amendament iu referove?

RAIF QELA: Amendamentit 8, gabim teknik, në vend të “mbetjeve” është “mbejteve”, vetëm të regjistrohet që është gabim teknik.

KRYETARI: Atëherë është çështje gjuhësore, rregullohet, po të evidentohet gabimi.

Amendamenti 9, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Kalon. Për janë të gjithë.

Amendamenti 10, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Jemi 92 deputetë në sallë. Kush është kundër? Abstenim? S'ka. Për janë të gjithë.

Amendamenti 11, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Kush është kundër? Armend Zemaj e ka fjalën për amendamentin 11. Urdhëro!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Unë mendoj që te paragrafi i shtuar, kur thuhet “pasuria e ‘Trepçës’ dhe rezultatet e saj financiare paraqiten, në pasqyrat e konsoliduara financiare të ‘Trepça’ sh.a....” mendoj se duhet të jetë “pasuria e ‘Trepçës’ dhe çfarëdo aktiviteti financiar paraqitet në pasqyrat e konsoliduara financiare të ‘Trepçës’ sh.a....”, sepse vetëm “rezultatet” është e mangët, por mund edhe propozuesi të japë shpjegim. Unë mendoj që çdo aktivitet financiar duhet të jetë në pasqyrat financiare.

KRYETARI: Jemi te amendamenti 11. Kryetari i Komisionit FunkSIONAL një interpretim, ose propozim.

MUHEMET MUSTAFA: Duhet të mbetet siç është në propozimin e Komisionit Funkcional, sepse çdo aktivitet financiar regjistrohet dhe paraqitet në pasqyrat financiare. Nuk ka aktivitet financiar që nuk përfshihet në pasqyrat financiare. Prandaj, mbetet kjo, por hiqet presja. Faleminderit, e pashë edhe një herë, presja nuk ka nevojë të jetë pas fjalës “paraqitet”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Votohet amendamenti 11 me vërejtjen e kryetarit të Komisionit Funkcional. Kush është kundër? Abstenim? Të gjithë jemi për. Jemi aktualisht 93 deputetë.

Jemi te amendamenti 12, me përkrahjen e Komisionit Funkcional. Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Abstenim 1. Janë 93 deputetë. Të tjerët janë të gjithë për. Ta marrim gjendjen. 93 deputetë, 6 abstenime, 87 deputetë. Kalon amendamenti 12.

Amendamenti 13, me përkrahjen e Komisionit Funkcional. Kush është kundër? Abstenim? 93 deputetë, kalon. 92, më falni se po lëviz...

Amendamenti 14, i kemi tri propozime. Përgatituni, do të votojmë për secilin prej tyre. Shkojmë te propozimi i parë, i cili është me përkrahjen e Komisionit Funkcional.

1) 91 deputet në sallë. Kush është... Komisioni Funkcional, amendamenti 14, 3 propozime. Në rend të parë e vë në votim propozimin e Komisionit Funkcional. Kush është kundër? A ka abstenim? 1 abstenim. Të gjithë janë për. 90 deputetë janë për, 1 abstenim.

Jemi në propozimin e dytë. Grupi parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, pa përkrahje nga Komisioni Funkcional.

Më lejoni të theksoj, ai amendament i cili merr më së shumti vota, ai kalon, ai propozim për amendament në fakt. Gjithsesi, jam i detyruar ta vë në votim. Më falni, në të tjerat e shkelim, por për këtë pjesë, Rregulloren s’e shkelim, se ka të bëjë drejtpërdrejt me ligjin.

E dëshiron dikush i Grupit Parlamentar “Vetëvendosje” fjalën? Urdhëro, Glauk.

GLAUK KONJUFCA: Sepse, problemin kryesor me Komisionin e kemi pasur që këtu, nëse e keni parasysh amendamentin e mëhershëm, të cilin e shqyrtuat, Kuvendi i Republikës së Kosovës zhvendoset vetëm në këtë pikën 10, po ne kemi insistuar që në pikën 9.9, aty ku shkruan që lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me themelimin, transformimin e plotë apo të pjesshëm dhe shuarjen e njësive biznese, ose investimit në projekte të reja, Bordi Mbikëqyrës, respektivisht Qeveria e Republikës së Kosovës si aksionari kryesor, duhet ta marrë miratimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Pra, propozimi i amendamentit të mëhershëm të Komisionit FunkSIONAL, për mendimin tim, është më i ngushtë, kurse propozimi i “Vetëvendosjes” ia jep Kuvendit, le të themi, kompetencën e plotë dhe rolin dhe përgjegjësinë e vërtetë që i takon. Prandaj, kërkoj që ky amendament të votohet.

KRYETARI: Më falni, vetëm një sqarim procedural. Në bazë të nenit 58, pika 4, jam i detyruar ta vë në votim, edhe pse shanset as teorike nuk janë, me praninë e 90 deputetëve që kanë votuar për propozimin e parë. Aktualisht, në sallë janë 87 deputetë.

2) Sido që të jetë, jemi te propozimi i dytë, për amendamentin 14, nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Në ndërkohë u bënë 88 deputetë, në qoftë se Danushi nuk ikën. Atëherë, kush është për? Edhe Aida është për. Kush është kundër? Jam i detyruar, më vjen keq, në bazë të Rregullores, unë e di se nuk ka kuptim, por jam i detyruar. A ka abstënim? Shumica janë kundër, vetëm ta konstatojmë.

E kemi edhe një propozim të tretë, i cili po ashtu... Deputeti Sabri Hamiti pastaj. Për kanë votuar 13 deputetë. Unë po i shoh 14 të “Vetëvendosjes”. Edhe Aida futet, pra 14. Kundër kanë votuar 73. Nuk kalon. Abstënim nuk ka.

3) Propozimi i tretë nga deputeti Sabri Hamiti. Profesor, a dëshiron ta arsyetosh? A po e lexon më mirë, se e arsyetoni ju. Pa përkrahjen nga Komisioni FunkSIONAL, por i absorbuar me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, neni 9, paragrafi 9, i shtohet teksti: “... i cili miratohet në Kuvendin e Kosovës.”

Sabri Hamiti e ka fjalën. Vëmendje!

SABRI HAMITI: Faleminderit!

Shikoni!

Këtu dihet, që shumica voton edhe pakica s’kalon me numra dhe nga kjo s’ka nevojë të bëjmë filozofi. Në daç me duar, në daç me gjysmë dore, në daç me aparat, del kështu.

Po, unë u paraqita sepse ky është shumë interesant. Ky është një amendament, të cilin unë e kam paraqitur i pari. Shumë mirë që më është bashkuar edhe një i dytë, e pastaj edhe komisioni. Dhe, çfarë ndodh?

Komisioni thotë “po i absorbojmë çfarë kanë thënë këta” dhe e ka dhënë variantin e vet të parë, pastaj e ka dhënë të dytin të “Vetëvendosjes”, të tretin të Sabri Hamitit. Në të vërtetë, amendamenti i “Vetëvendosjes” dhe ky imi pak a shumë janë i njëjti. Edhe i komisionit, faktikisht është si i njëjtë, por nuk është i njëjti se është i absorbuar.

E tash, unë dola t'ju them këtu, e di se as që më vret derti që unë e kam propozuar, nëse e kanë absorbuar ju bëftë mirë, se s'më thotë mua gjë, mirëpo komisioni duhet të jetë i kujdesshëm, shumë i kujdesshëm, prandaj duhet të vihet. Nuk ka nevojë këtu të jepen dhënë këso farë specifikimesh "mos e votoni se e gjeni tjetërkund". Jo, nuk gjendet në dy vende. Unë nuk jam marrë me statutin, unë jam marrë pikërisht me pikën 9.9. Dhe, duhet të shkruhet teksti i plotë, të cilin ua kam dorëzuar, sepse edhe të tjerët e kanë marrë tekstin e plotë, kanë mbindërtuar në të. Është dashur dhe amendamenti im është në mënyrë jokorrekte i paraqitur në dokument.

Prandaj, unë votoj për amendamentin tim, sepse nuk është absorbuar në 10-sh. Ky është problem tjetër. Unë nuk jam marrë me..., besoj që është qartë. Unë tutje nuk kam çfarë shpjegoj edhe në qoftë edhe një votim nëse është, unë votoj për korrektësi dhe për variantin tim, se nuk absorbohet në 10-shin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit FunkSIONAL e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Deputeti Sabri Hamiti ka të drejtë, sepse është dashur të shkruhet teksti i tij dhe të prezantohet dhe aty do të shihej se ai nuk është identik me të "Vetëvendosjes". Ka ngjashmëri, por s'është identik. Por, nuk thashë çka the ti, unë po them çka po them unë, Sabri. Mos më ndërhyj tash, të lutem! Domethënë nuk është identik, ka ngjashmëri dhe disa elemente të këtij amendamenti ne i kemi absorbuar. Unë ju propozoj ta aprovoni propozimin e Komisionit FunkSIONAL. Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë formalisht. Kjo është arsyeja përse Rregullorja duhet të ndryshohet sa më shpejt.

Po votojmë për të njëjtën çështje. Aktualisht i kemi vetëm 83 deputetë. Edhe 83 po të votojnë për, prapë kanë votuar për Komisionin FunkSIONAL. Sido që të jetë, deputeti Sabri Hamiti pa përkrahje nga Komisioni FunkSIONAL, amendamenti 14, propozimi i tretë, kush është për? Kush abstenon? S'ka abstenim. Kush është kundër? Kalon propozimi i parë. Derisa Administrata t'i mbledhë votat, sido që të jetë propozimi i parë është i palëkundshëm. Janë 21 për, 32 kundër, të tjerët 13 abstenim nga këta që kanë votuar. Tek amendamenti 14 kalon propozimi i Komisionit FunkSIONAL, propozimi i parë.

Amendamenti 15, propozim i Komisionit FunkSIONAL. Kush është kundër? Praninë, ju lutem! Kush është kundër? A ka abstenim? Kalon me 88 vota.

Amendamenti 16, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Kush është kundër? A ka abstenim? Kalon me 88 vota.

Në ndërkohë edhe Lahiu erdhi, gjithsej 89.

Amendamenti 17, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Urdhëro, Glauk!

GLAUK KONJUFCA: Puna është kështu, te neni 12 i ligjit, sipas versionit që ka sjellë Qeveria, këtu ekziston që në kuadër të procesit të transformimit, kushtet që krijohen për zhvillimin e ndërmarrjes dhe në formë të masave paraqiten 4 kategori, që është partneriteti publiko-privat, investimet direkte private, investimet e përbashkëta dhe emetimi dhe shitja e aksioneve.

Propozimi i “Vetëvendosjes” është që këtyre katër kategorive t’u shtohen edhe tri të tjera, për ta funksionalizuar më mirë dhe që masat për zhvillimin e “Trepçës” të jenë më të prekshme.

Tri kategoritë, që ne propozojmë të shtohen, janë:

1. Kreditë shtetërore,
2. Kreditë e kompanisë, si dhe
3. Emetimi dhe shitja e obligacioneve.

Edhe e kam edhe një diskutim sa i përket kësaj punës që Qeveria zakonisht thirret në konsensus për t’i çuar çështjet shumë të rëndësishme të Kosovës përpara, e unë, çfarë pashë deri tash, këtu në Kuvend dhe çka kam parë në Komisionin në të cilin isha, të Zhvillimit Ekonomik, këtu ka një kokëfortësi, disi sikur për inati për t’i votuar çështjet kundër vetëm se i propozon Lëvizja “Vetëvendosje”.

Domethënë, kjo nuk është mirë, për arsye se unë po shoh që deputetët e koalicionit shumë më shumë janë në gjendje ta dëmtojnë ndoshta edhe interesin e Kosovës vetëm pse s’po pajtohen prej kujt vjen ideja, veç se po vjen prej opozitës - prej “Vetëvendosjes” po organizohen të votojnë kundër.

Kjo nuk mendoj se as s’i kontribuon konsensusit, sikur që po thoni ju, as në të mirë të Kosovës. Ju neve po na mbani ligjëratat përditë qysh duhet të tejkalohe interesat e ngushta partiake.

Ja qysh tejkalohe interesat e ngushta partiake, nëse ne po votojmë deri tash 5 apo 6 amendamente të Qeverisë i votuam, asnjë amendament i Lëvizjes së “Vetëvendosjes” nuk u votua deri tash, vetëm për shkakun kah vjen, prej Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Kështu ju i kontribuoni Kosovës. Kjo është katastrofë!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në pjesën e votimit, nuk ka diskutime, sepse edhe kështu jemi vonë, është ora 1:10.

Arben, s'ke folur moti! Arbeni e ka fjalën, shkurt.

ARBEN GASHI: Faleminderit! Vetëm një përgjigje të shkurtër për Glaukun. Ne këtu, në këtë anën e LDK-së, patëm shumë simpati për deklaratën e Glaukut se nëse ka dyshim se ndonjë deputeti nuk po i numërohet vota, është shkelje e Kushtetutës dhe e së drejtës së votimit, bile edhe e përkrahëm, kështu që kur pate të drejtë, të përkrahëm, Glauk.

Për këto rastet e tjera, konsensusi është... Ju përkrahët disa vendime të mira dhe nëse ka ndonjë propozim të mirë nga ana e “Vetëvendosjes”, të jesh i sigurt se do ta përkrahim, por deri tash konceptet politike, me një koncept të majtë, me një koncept të djathtë nuk përputhen dhe është normale, hyn në procesin e votës dhe vendoset. Faleminderit!

KRYETARI: Profesori e ka fjalën. Është nga Komisioni FunkSIONAL, duhet të flasë.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar, unë mendoj që ky diskutimi lidhur me këtë, vërtet është vetëm në këtë kohë të vonë, është një retorikë dhe më vjen keq sepse patëm një diskutim të mirë, edhe me Glaukun në Komision, por tash nuk është koha për këso retorike.

Këto që janë shtuar këtu, nuk kanë të bëjnë me përmbajtjen e këtij kapitulli. Ato janë burime të financimit, të cilat caktohen me studim fizibiliteti dhe s'kanë të bëjnë me këtë nen fare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë Glauku dëshiron replikë!

GLAUK KONJUFCA: Unë po ia kthej replikën Arbenit, e Visari ia kthen replikën Muhamet Mustafës.

Sa i përket çështjeve - të mira, të këqija që i propozojmë ne, tash Arbeni po i zhvendos në dallime ideologjike.

Unë e kam një pyetje shumë të thjeshtë. Qeveria ka qenë vendimmarrëse që posta të funksionojë si ndërmarrje publike.

Nëse ky qenka koncept i majtë, të cilin po e propagandon Lëvizja “Vetëvendosje”, a është Qeveria e majtë, pra e Republikës së Kosovës që e përkrah funksionimin e PTK-së edhe sot e kësaj dite si ndërmarrje publike.

Ne këtë po e kërkojmë edhe për “Trepçën”, që të ketë të njëjtin kategorizim – statusin t'ia jepni si ndërmarrje publike, sepse mendojmë që kjo jep garanci shumë më të mëdha të mbrojtjes.

Pra kjo, Arben, nuk ka lidhje me debatin ideologjik që zhvillohet këtu, sepse vetë Qeveria që ju e udhëhoqi ka në pronësi dhe udhëheq shumë ndërmarrje publike, dhe pajtohet që ato të jenë publike. Pra, kjo s'ka lidhje me atë që po thoni ju, me dallimet ideologjike, apo çka po di unë.

KRYETARI: Atëherë, kalojmë në votim.

Amendamenti 17. Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Ju lutem, të votojmë!

Kush është për amendamentin 17?

A ka abstenim?

Kush është kundër?

Ju lutem me ngritje dore, deklarohuni kush është kundër!

(Ndërrhyrje)

Për fjalë paraqituni më vonë, ju lutem! S'mund të flasësh dhjetë herë.

Do të bëhem rigjid në Rregullore këtë herë, se po më kritikoni që po e shkel.

Pra, në bazë të Rregullores, vetëm një mund të flasë. Ngadalë se deri sa ne po lexojmë, Rregullorja po shfletohet.

Jemi te amendamenti 17.

Për, asnjë. Kundër 38, për 2. Kundër 38 dhe 35 73, abstenim nuk ka, nuk kalon.

Amendamenti 18. Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Kush e do fjalën? Visar Ymeri, nga Lëvizja “Vetëvendosje”.

VISAR YMERI: Së pari kryetar, jeni duke e udhëhequr këtë seancë, të cilën vetë e quajtet shumë të rëndësishme, në mënyrën më katastrofave të mundshme.

Askund në Rregullore s'shkruan që nuk bën të flitet për amendamente. Ky është një fikSION që e keni ju dhe disa deputetë, që s'di as ku e keni marrë.

Për amendamente, madje-madje, nëse shikohet logjikisht duhet diskutuar më shumë se sa për ligjin në parim, sepse këtu e merr ligji formën përfundimtare të tij, e në formën përfundimtare të ligjit ju po thoni se s' duhet të ketë debat.

Këtë unë s'mund ta kuptoj dhe s'po e quaj as logjikë e mbrapsht, sepse s'është as logjikë.

Po flas për amendamentin e kaluar, sepse këtu padrejtësisht dhe në mënyrë jashtëzakonisht dashakeqe u keqinterpretua amendamenti.

E kam dëgjuar në Komision dhe e dëgjova edhe më herët. Këtu thuhet, po ua lexoj tekstin, sepse një pjesë e deputetëve mbase s'e ka lexuar fare.

Pra, "Trepça" SHA, në kuadër të procesit të transformimit dhe ristrukturimit, me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillimin dhe rehabilitimin e saj, do të përdorë modalitetet e investimeve sikur të mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to. Dhe, pastaj ravijëzohen 4 që kanë qenë si propozim prej Qeverisë dhe 3 të tjera që i propozon Lëvizja "Vetëvendosje".

Pra këtu, ai deputet që voton kundër, njëkohësisht e voton krejt tekstin e amendamentit kundër. E në tekstin e amendamentit thuhet se "Trepça" duhet të ketë qëllim të krijojë kushte për zhvillimin dhe rehabilitimin e saj, që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës po thonë se jemi kundër. A bën ta dimë për çka jeni për? Sepse, të shohim sa më skandalozë janë këta deputetë!

Këqyrni çka kanë votuar kundër!

(Ndërhyrje)

Amendamenti 3, i propozuar po ashtu nga Lëvizja "Vetëvendosje", thotë – t'i shtohet fjalia kështu "e transformuar në njësite biznesore të parapara me këtë projektligj si ndërmarrje publike qendrore në pronësi të Republikës së Kosovës". Dhe deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë votuar kundër që "Trepça" të jetë pronësi e Republikës së Kosovës.

Pra, këta deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës i keni në kamerë, e kanë ngritur dorën që "Trepça" të mos jetë ndërmarrje publike në pronësi të Republikës së Kosovës.

Le të etablohet kjo, sepse turpi është pak t'u thuhet këtyre deputetëve, të cilët aktivisht janë të angazhuar për ta dëmtuar me vetëdije interesin e Republikës së Kosovës, në këtë rast atë ekonomik të Republikës së Kosovës, i cili goxha shumë trupëzohet në ndërmarrjen "Trepça".

E tash po flasim për amendamentin që e kem në radhë, amendamentin 18.

Këtë amendament e kemi propozuar në mënyrë që kjo shkelje që bëhet këtu, në këta dy paragrafë, të shmanget.

Pra, shih çfarë thonë paragrafët. Paragrafët thonë se kur “Trepça” SHA është pronare e mbi 50% të aksioneve, nëse është në bashkëpronësi me një ndërmarrje private, atëherë “Trepça” mund t’ia lërë menaxhimin asaj ndërmarrje private.

Kur është e anasjellta, në nenin 4, atëherë automatikisht investitori privat e merr menaxhimin e asaj njësie biznesore.

Pra, po shihni se logjika këtu është që po i nacionalizojmë humbjet dhe po i privatizojmë fitimet. Kjo është logjika që përvidhet në krejt Ligjin për “Trepçën” e që qe besa e ka një materializim pak më eksplisit në këto dy nene që i përmenda, prandaj ne kemi kërkuar që këto të fshihen, sepse menaxhimi i një ndërmarrje, njësie biznesore ose ndërmarrje përcaktohet me Ligjin për ndërmarrjet publike sipas përqindjes së aksioneve që pronësojnë dy investitorë ose tre investitorë, ose sado investitorë aksionarë që janë në të.

Pra, nëse aksionar shumicë është Qeveria, në këtë rast “Trepça” SHA, atëherë natyrisht se “Trepça” SHA e bën menaxhimin e asaj njësie.

Nëse kapitalin privat e pronëson përmbi 50% të aksioneve, atëherë logjikisht se ata do ta kenë edhe menaxhimin. Pra këtu pesha e aksionarëve po zbutet në nenin 3, paragrafin 3 të këtij neni, kjo për t’i krijuar hapësirë një investitori privat që ata ta menaxhojnë edhe kur pronësohet formalisht me shumicë nga “Trepça” SHA.

Prandaj, këto dy nene duhet të fshihen, në mënyrë që kjo, siç është e rregulluar me ligje të tjera, të rregullohet edhe në rastin e “Trepçës”.

KRYETARI: Tash me radhë është Ganimete Musliu dhe kryetari i Komisionit FunkSIONAL e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

U bë interesant tash këtu për amendamentet. Unë nuk po mund ta kuptoj “Vetëvendosjen”. Në njëërën anë apelojnë e thonë përkrahni amendamentet.

Ishte amendamenti 17, që këta bënë zhurmë t’i përkrahim, dhe unë e Naiti i përkrahëm, votuam për, ata s’votuan asnjë. S’po mund të kuptoj a t’i përkrahim apo të mos i përkrahim.

KRYETARI: Zotëri Mustafa, fjala për ju!

MUHAMET MUSTAFA: Më duhet të intervenoj për shkak se po na dëgjon opinioni dhe duhet të ketë interpretim të saktë. Interpretimi që e dëgjuam, nuk është i saktë.

Interpretimi i saktë i këtij amendamenti është se kur investitori privat ka më pak se 50% me qëllim që investitori privat edhe kur s'i merr mbi 51% të aksioneve të jetë i motivuar të investojë, atëherë mund të bëjë një kontratë që ai të ketë edhe një pjesëmarrje në menaxhment, sepse investitori privat nuk investon më pak se 51%, e ne mund të kemi interes bile shumë të madh për Kosovën që edhe kur investitori privat i ka 10% apo 20%, të investojë.

Këso praktike kemi në Kosovë dhe është treguar e suksesshme. Pra, interpretimi ishte i shtrembëruar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Replikë nga Visar Ymeri!

VISAR YMERI: Në fakt, mua po më duket se nganjëherë profesor Mustafa ose s'po do të lexojë, s'po sheh ose s'po di, sepse këtu është shumë e qartë.

Ai tha, dhe mund të dëgjojmë prapë se është e incizuar, ai tha që të ketë pjesëmarrje në menaxhim, e këtu thuhet shumë qartë se mund të vendosë aranzhmane kontraktuale për qeverisje dhe menaxhim, jo pjesëmarrje se këtu është kapitali privat. Por, kur kapitali privat i ka nën 50% të aksioneve, atëherë me një marrëveshje kontraktuale, që e thashë unë edhe në fillim dhe nuk e shtrembërova, thashë me një marrëveshje kontraktuale mund t'i kalojë tërësisht nën menaxhim ajo njësi biznesore. Jo pjesëmarrje në menaxhim dhe qeverisje, tërësisht. Kështu e thotë neni. Lexoje me vëmendje!

KRYETARI: Atëherë, shkojmë në votim. Gjërat janë, profesor, të qarta! Pra, të shkojmë në votim, sepse mirë e kemi qartësuar dhe falënderoj për këtë interaktivitet.

Janë 92 deputetë në sallë.

Është amendamenti 18. Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje", pa përkrahje nga Komisioni Funkcional.

(Ndërhyrje)

Urdhëro, kundër-replikë! Dhe pastaj, të përgatitemi për votim. E ka fjalën Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Duhet të jemi korrektë se jemi para opinionit dhe kjo është çështje e rëndësishme.

Pika 3, faqja 13, është vetëm për aranzhmane kontraktuale. Askund nuk është fjala - tërësisht. Askund!

Prandaj, nuk duhet të abuzojmë në këtë kohë me opinionin.

KRYETARI: Jemi në votim.

Amendamenti 18. Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, pa përkrahje nga Komisioni FunkSIONAL.

93 deputetë janë të pranishëm!

Kush është për?

A ka abstenim? 4 abstenime.

Atëherë, konstatojmë se pjesa tjetër është kundër, vetëm të marr gjendjen.

Janë 93 deputetë të pranishëm. Për janë 16, 4 abstenime dhe pjesa tjetër kundër, nuk kalon.

Amendamenti 19. Komisioni FunkSIONAL.

Të pranishëm janë 92 deputetë.

Kush është kundër? Nuk ka.

Urdhëroni! Visar Ymeri e ka fjalën, jemi te amendamenti 19.

VISAR YMERI: Ky amendament e trajton çështjen e pronave të “Trepçës” që janë jashtë vendit. Dhe, mendoj se është i kotë si tekst, dhe është vetëm sa për të thënë se po bëjmë diçka për ato prona, sepse thuhet këtu që - kërkohet nga AKP-ja të marrë të gjitha aktivitetet e nevojshme për t’i realizuar të drejtat e Kosovës.

AKP-ja është qe 15 vjet, dhe kjo s’është kurrëgjë, s’është për ligj. Kjo është shprehje e vullnetit të mirë nga Kuvendi, që është kot. Këtë desha ta qartësoj për publikun se këtu nuk është duke u bërë nami me këtë pikë.

KRYETARI: 92 deputetë të pranishëm. Të përgatitemi për votim, është amendamenti 19.

Janë 92 deputetë të pranishëm!

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Janë 13 kundër, 79 deputetë për, pa abstenim.

Do të thotë, ky amendament kalon.

Amendamenti 20, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Janë të pranishëm 92 deputetë në sallë.

Kush është kundër?

A abstenon ndokush?

Kalon me 92 vota.

Amendamenti 21. Deputeti Sabri Hamiti, me përkrahje nga Komisioni FunkSIONAL.

Kush është kundër?

Abstenim?

92 deputetë janë për, kalon.

Të nderuar deputetë, jemi te votimi i tekstit të projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Do të votojmë me dorë, apo me elektronikë? Sala Berisha-Shala e ka kërkuar fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Kryetar, faleminderit!

E di që u bë shumë vonë dhe e di që është pak e mundimshme, por e kam një propozim.

Ky material do shkojë në Zyrën për Standardizim e Harmonizim dhe theksoj që janë disa shprehje që komisionet në shpejtësi s'kanë pasur mundësi t'i shohin, si për shembull shprehjet "do të...", "duhet..."

Dhe më lejon të marr vetëm një shembull, te amendamenti 19 dhe kjo përcillet gati gjithkund në projektligj.

- "AKP duhet t'i ndërmarrë të gjitha aktivitetet...", e kështu me radhë...

Mendoj se duhet të jetë:

- "AKP i ndërmerr të gjitha aktivitetet".

Them që duhet spastruar prej këtyre shprehjeve, sepse gjuha e ligjit nuk i duron ato, pra shprehjet - “do të...”, dhe “duhet...”, aty ku nuk e prish esencën.

Amendamenti 19, në qoftë se është “duhet”, bash gjuha e ligjit, e nderuar deputete, kur ligji thotë “duhet”, e jo “do të...”, por duhet, sepse në gjuhën shqipe është shumë e qartë, dhe këtu e kemi profesorin nëse ka nevojë për qartësime të plota.

Pra, do të votojmë me dorë dhe jemi të përgatitur për votim dhe votohet teksti i projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Sa deputetë jemi të pranishëm?
Janë 93.

Kush është kundër këtij ligji? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush? 14 abstenojnë.

Dhe, kush është për?

Pra, 14 deputetë kanë abstenuar, kundër s’ka.

Pra, kanë votuar për 79 deputetë dhe konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin për “Trepçën”.

Me fat! Dhe me këtë i mbyll punimet e seancës plenare. Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*